



REPUBLIKA E SHqipërisë
MINISTRIA E BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
AGJENCIA PËR ZHVILLIM BUJQËSOR DHE RURAL

Tiranë, më 30.09.2020

NJOFTIM

ULET VIJA E FINANCIMIT PËR KATËR MASAT MBËSHTETËSE

Agjencia për Zhvillim Bujqësor dhe Rural njofton uljen e vijës së financimit për fermerët aplikantë, të cilët kanë përmbushur kriteret e vendosura për masat mbështetëse Nr.,1, 2 dhe 4, bazuar në Ligjin Nr. 88/2019 datë 18.12.2019 'Për buxhetin e vitit 2020', Aktit Normativ të datës 6 Korrik 2020, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 100, datë 5.2.2020, 'Për përcaktimin e kriterëve bazë, të sektorëve që do të mbështeten dhe të masës së përfitimit nga fondi i Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural, për vitin 2020', Udhëzimit të Përbashkët të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.3, datë 24.2.2020, 'Për kriteret, procedurat dhe mënyrën e administrimit të Fondit të Programit për Bujqësinë dhe Zhvillimin Rural', të ndryshuar, si dhe Urdhrit të Ministrit nr. 278, datë 16.07.2020 , “Për alokimin e fondit shtesë të Programit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural.

Njoftimi mbi uljen e vijës së financimit për “**Listat e Aplikimeve të Kualifikuara**”, gjendet në faqen zyrtare: www.azhbr.gov.al, për tre masat mbështetëse të lartpërmendura, financuar nga Programi Kombëtar, viti 2020. Gjithashtu **Agropikat** janë në gatishmëri për dhënie informacioni të aplikantëve të cilët janë brenda vijës së financimit.

Më poshtë po ju njoftojmë numrin rendor të aplikantëve që janë përfshirë mbi vijën e financimit.

- **Masa 1:** Tufa bazë e matrikulluar – Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 3160
- **Masa 2:** Bletaria- Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 1390
- **Masa 4:** Mbjellje bimësh mjekësore dhe aromatike - Do të përfshihen në fond aplikimet deri në numrin rendor 283

Afati i dorëzimit të dokumenteve shtesë për aplikantët që ndodhen mbi vijën e financimit është deri më datë **14.10.2020**. Dorëzimi përtej këtij afati do të rezultojë me skualifikim të aplikimit.